REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KRYETAR

Nr. 13432 Prot

Shkodër, më 27.6.2024

**Lënda:** Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni.

**KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR**

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëngjitur, Ju dërgojmë për shqyrtim jashtë rendit të ditës projekt-vendimin dhe relacionin:

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FONDACIONIT SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINE DHE BASHKISË SHKODËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SUNNY SCHOOLS", I CILI KA PËR QËLLIM INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE (PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE PËRMES ENERGJISË DIELLORE) NË SHKOLLAT E MESME "JORDAN MISJA", "OSO KUKA", "NIKOLLË ZAGORJANI" DHE SHKOLLAT 9 VJECARE "DËSHMORET E PRISHTINËS", "EDITH DURHAM", "TRINGË SMAJLI" GRUDË, "DESHMORET RRENCIT".**

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**Z / KRYETAR**
**Onid BEJLERI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA SHKODËR

Nr._____ Prot

Shkodër, më ____.____.2024

**PROJEKT - VENDIM**
**Nr.______, datë____.____.2024**

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FONDACIONIT SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINE DHE BASHKISË SHKODËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SUNNY SCHOOLS", I CILI KA PËR QËLLIM INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE (PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE PËRMES ENERGJISË DIELLORE) NË SHKOLLAT E MESME "JORDAN MISJA", "OSO KUKA", "NIKOLLË ZAGORJANI" DHE SHKOLLAT 9 VJECARE "DËSHMORET E PRISHTINËS", "EDITH DURHAM", "TRINGË SMAJLI" GRUDË, "DESHMORET RRENCIT", SI EDHE DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NËNSHKRIMIN E SAJ KRYETARIT TË BASHKISË"**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës ___/___ 2023, me propozim të kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjit nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; të ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; të ligjit nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar,VKM nr.510,datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve,personelit,aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial, si dhe relacionit të administratës së bashkisë Shkodër:

**V E N D O S I:**

1.Të miratojë në parim marrëveshjen bashkëpunimit ndërmjet fondacionit shoqëria e hapur për Shqipërine dhe bashkisë Shkodër për zbatimin e projektit "Sunny Schools", i cili ka për qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në shkollat e mesme "Jordan Misja", "Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani" dhe shkollat 9 vjecare "Dëshmoret e Prishtinës", "Edith Durham", "Tringë Smajli" Grudë, "Deshmoret Rrencit", si edhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e saj kryetarit të bashkisë si edhe dhënien e autorizimit për nënshkrimin e saj kryetarit të bashkisë.

2.Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Kryetari i Bashkise.

3.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**Z / KRYETAR**

**Onid BEJLERI**

Zv/Kryetar

Drejtoria e Mjedisit, dhe energjise së rinovueshme

Drejtoria pergjithshme juridike,burimeve njërezore dhe shërbimeve mbështetese

Drejtoria Juridike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E MJEDISIT DHE ENERGJISË SË RINOVUESHME

Nr._____ Prot                                                                 Shkodër, më ____.____.2024

# RELACION

**"PËR MIRATIMIN NË PARIM TË MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT NDËRMJET FONDACIONIT SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINE DHE BASHKISË SHKODËR PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SUNNY SCHOOLS", I CILI KA PËR QËLLIM INSTALIMIN E IMPIANTEVE FOTOVOLTAIKE (PRODHIM ENERGJIE ELEKTRIKE PËRMES ENERGJISË DIELLORE) NË SHKOLLAT E MESME "JORDAN MISJA", "OSO KUKA", "NIKOLLË ZAGORJANI" DHE SHKOLLAT 9 VJECARE "DËSHMORET E PRISHTINËS", "EDITH DURHAM", "TRINGË SMAJLI" GRUDË, "DESHMORET RRENCIT" .**

Një nga strategjitë kryesore të bashkisë është "tranzicioni i gjelbër" , kjo strategji gjithëpërfshirëse do të kontribuojë në kursimin e energjisë, rritjen e përdorimit të burimeve të energjisë diellore, erës, hidroenergjisë dhe reduktimin e $CO_2$.
Një nga objektivat e kësaj strategjie është edhe Adresimi i sfidës se efiçencës së energjisë nëpërmjet përdorimit të burimeve të mëdha të energjisë së rinovueshme duke ofruar përmirësime të Eficiences se Energjisë në përgjithësi për të gjitha shërbimet e drejtpërdrejta bashkiake (ndërtesat dhe sherbimet publike), si dhe të gjithë sektorët indirect si sektori rezidencial, turizmi, shërbimi privat dhe tregtar, industria, bujqësia dhe transporti privat.

Kjo strategji e bashkisë është në përputhje të plotë me Strategjinë Kombëtare për Energji dhe Klimë 2020-2030 si edhe Planin Vendor të Veprimit për Energji dhe Klimë të miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr 34 dt 31.05.2024. .Ky dokument parashtron kontributin e Bashkisë: kursim në emetimet e GS-ve prej 18.7%, ulje të konsumit final të energjisë me 8.4% dhe energji të rinovueshme.

Promovimi i këtyre politikave/strategjive dhe objektivave të Bashkisë Shkodër ka sjellë edhe ndjeshmërinë e subjekteve të ndryshme për ofrimin e shërbimeve të tyre në zbatimin e këtyre objektivave.

Kështu Bashkia Shkodër ka përzgjedhur 7 objektet publike ( Shkolla) për të qënë pjesë e marrëveshjes me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë i cili merr përsipër për kryerjen e një investimi me qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), duke përfshirë funksionimin dhe mbarëvajtjen për një periudhë dy vjeçare. ( Bashkëlidhur)

Bashkia Shkodër dhe përfaqësuesit e Fondacionit kanë rënë dakort që pjesë e këtij investimi të jenë :
Shkollat e mesme të përgjithëshme " Jordan Misja" dhe " Oso Kuka" në qytetin e Shkodrës, dhe shkolla " Nikoll Zagorjani" në NJA Velipojë, si edhe Shkollat 9 vjecare "Dëshmoret e Prishtinës"dhe "Edith Durham", në qytetin e Shkodrës, " Shkolla 9 vjecare "Tringë Smajli" në fshatin Grudë , NJA Rrethina dhe shkolla 9 Vjecare " Dëshmorët e Rrencit" në fshatin Rrenc , Nja Gur i Zi.

Objektet arsimore "Shkolla e Mesme " Jordan Misja" dhe " Oso Kuka" janë të pajisura më Certifikatë Pronësie, Shkolla 9 vjecare " Dëshmorët e Rrencit" pjesë e inventarit të pronave kaluar me VKM nr 1088/2008 " Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike , shtetërore që kalojnë në pronësi osë përdorim të Komunës Gur i Zi Qarku Shkodër" , Shkolla 9 vjecare " Dëshmorët e Prishtinës" pjesë e pronave të Bashkisë Shkodër kjo bazuar ne VKM nr 421/2010 " Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtëshme publike , shtetërore që kalojnë në pronësi osë përdorim të bashkisë Shkodër , Qarku Shkodër" , Shkolla 9 vjecare " Nikoll Zogorjani " , Shkolla 9 vjecare " Tring Smajli" janë pjesë e inventarit të ish Komunave përkatëse Velipoje e Rrethina të miratuara si prona të tilla me Vendimet përkatëse të Këshillve bashkiakë përkatësisht Vendimin e ish Komunes me nr.6 date 11.12.2013 dhe Vendimin e ish Komunes Velipoje me nr.33 date 11.12.2013, Shkolla 9 vjecare " Edith Durham" pjesë e inventarit kontabël të bashkisë Shkodër në procedurë për kalim pronësie.

Kjo përzgjedhje është bërë për faktin se janë Shkolla të cilat kanë një konsum vjetor të energjisë të konsiderueshëm, kanë numër të lartë nxënësish që frekuentojnë shkollën ( si më poshtë) si edhe janë objekte me mbulesë catie- soletë e cila është e përshtatëshme për vendosjen e paneleve fotovoltaike.

| **Emërtimi I Objektit** | **Nr nxënës** | **lek/vit (energji )** |
|---|---:|---:|
| Shkolla e mesme Oso Kuka | 565 | **249,981** |
| Shkolla e mesme Jordan Misja | 171 | **170981** |
| Shkolla e Mesme N. Zagorjani Velipoje | | **139,733** |
| Shkolla 9 vjecare Edit Durhan | 168 | **650,014** |
| Shkolla 9 vjecare Deshmoret e Prishtines | 240 | **194,887** |
| Shkolla 9 vjecare "Tring Smajlaj" Grude | 229 | **196,979** |
| Shkolla 9 Vjeçare "Dëshmorët e Rrencit" Rrenc | 50 | **109,593** |
| TOTAL | **1423** | **1,712,168** |

Marrëveshja parashikon qëllimin dhe detyrimet e seicilës palë pjesë e kësaj marrëveshje ku një nga këto qëllime është : Energjia elektrike që do të prodhohet nga këto impiante do të përdoret nga Bashkia Shkodër me qëllim për të ulur konsumin e saj të përgjithshëm nga rrjeti publik i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duke krijuar kështu një kursim direkt në faturat e energjisë elektrike.

Sic edhe shihet nga tabela kursimi i energjisë elektrike në total për 1 vit është 1,711,889 lek , një vlerë e konsiderueshme monetare që kursehet.

Bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; ligjin nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar; të ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; ligjin nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar,VKM nr.510,datë 10.06.2015 "Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve,personelit,aktiveve dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial,

Ju ftojmë "Për Miratimin Në Parim Të Marrëveshjes Së Bashkëpunimit Ndërmjet Fondacionit Shoqëria E Hapur Për Shqipërine Dhe Bashkisë Shkodër Për Zbatimin E Projektit "Sunny Schools", I Cili Ka Për Qëllim Instalimin E Impianteve Fotovoltaike (Prodhim Energjie Elektrike Përmes Energjisë Diellore) Në Shkollat E Mesme "Jordan Misja", "Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani" Dhe Shkollat 9 Vjecare "Dëshmoret E Prishtinës", "Edith Durham", "Tringë Smajli" Grudë, "Deshmoret Rrencit" .

Duke ju falenderuar!

**KRYETAR**

**Benet BECI**

**ME VENDIM DELEGIMI**
**Z / ~~KRYETAR~~**

**Ønid BEJLERI**

BASHKIA SHKODËR - REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtoria e mjedisit dhe energjisë së rinovueshme.

Aida Shllaku

**BASHKIA SHKODËR**
Nr__________ Prot
Shkodër më ______________

FONDACIONI SHOQËRIA E HAPUR PËR SHQIPËRINË
Nr ______________ Prot
Tiranë më ______________

# MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA, regjistruar si person juridik me Vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, nr. 43, datë 11.07.1994, me NIPT J62005011N, me seli në adresën: Rr. "Qemal Stafa", Pallati 120/2, Tiranë, përfaqësuar nga **Z. Andi Dobrushi**, Drejtor Ekzekutiv, në vijim e cilësuar si ***"Fondacioni"***.

*dhe*

Bashkia Shkodër, me adresë: Rruga "13 Dhjetori", Nd. 9, H 1,4001, Shkodër, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Benet Beci**, Kryetar, në vijim e cilësuar si ***"Bashkia"***.

(më poshtë veçmas referuar si ***"Pala"*** dhe së bashku si ***"Palët"***)

## Neni 1
## Objekti dhe Qëllimi i Marrëveshjes

1.1 Objekt i kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe Fondacionit është përcaktimi i roleve dhe angazhimeve të ndërsjella në zbatimin e projektit të përbashkët në Bashkinë Shkodër "Sunny Schools", i cili ka për synim angazhimin e Fondacionit për kryerjen e një investimi me qëllim instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore), duke përfshirë funksionimin dhe mbarëvajtjen për një periudhë dy vjeçare në ndërtesat e shkollave të mesme publike "Jordan Misja","Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani", si dhe në shkollat 9-vjeçare "Dëshmoret e Prishtinës", "Edith Durham","Tringë Smajli" Grudë, dhe shkollën 9-vjeçare Rrenc.

1.2 Energjia elektrike që do të prodhohet nga këto impiante do të përdoret nga Bashkia Shkodër me qëllim për të ulur konsumin e saj të përgjithshëm nga rrjeti publik i Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) duke krijuar kështu një kursim direkt në faturat e energjisë elektrike.

1.3 Kjo marrëveshje ka për qëllim rregullimin e marrëdhënieve institucionale midis Bashkisë Shkodër dhe Fondacionit në funksion të zbatimit të projektit "Sunny Schools" i cili synon angazhimin e Fondacionit për kryerjen e një investimi, me qëllim instalimin e impianteve

fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) mbi ndërtesat e shkollave publike "Jordan Misja","Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani", si dhe në shkollat 9-vjeçare "Dëshmoret e Prishtinës", "Edith Durham","Tringë Smajli" Grudë, dhe shkollën 9-vjeçare Deshmoret e Rrencit.

## Neni 2
## Baza ligjore

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi bazohet në nenin 9, pika 1.6, shkronja "a", nenin 34, pika 3, nenin 35 pika 1/d, nenin 36 pika 2, dhe nenin 64, shkronjat "a" dhe "gj" ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; nenin 20 të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjen Vendore",i ndryshuar; në ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" të ndryshuar; në ligjin nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat Jofitimprurëse" i ndryshuar;

## Neni 3
## Rolet dhe përgjegjësitë e palëve

***3.1 Fondacioni merr përsipër:***

Të ofrojë mbështetje financiare në shumën e përafërt prej rreth 110,000 Euro (njëqind e dhjetë mijë Euro, ose ekuivalenti në Lek) për kryerjen e investimit në instalimin e impianteve fotovoltaike (prodhim energjie elektrike përmes energjisë diellore) në ndërtesat e shkollave publike "Jordan Misja","Oso Kuka", "Nikollë Zagorjani", si dhe në shkollat 9-vjeçare "Dëshmoret e Prishtinës", "Edith Durham","Tringë Smajli" Grudë, dhe shkollën 9-vjeçare Rrenc.

a. Duke përfshirë funksionimin dhe mbarëvajtjen për një periudhë dy vjeçare
b. Investimi për instalimin e impianteve fotovoltaike do të realizohet nëpërmjet subjekteve të treta, të cilat nuk janë palë në këtë marrëveshje, nëpërmjet identifikimit, prokurimit dhe kontraktimit të tyre nga ana e Fondacionit.
c. Të angazhohet që investimi të sigurojë standard të lartë teknik dhe të vendosë në dispozicion të të gjitha palëve të interesuara informacion të plotë mbi investimin e kryer.
d. Të njohë të drejtën e pronësisë Bashkisë Shkodër mbi impiantet fotovoltaike mbas realizimit të investimit. Fondacioni do të ketë të drejtën që të shoqërojë procesin deri në konsolidimin e qasjes pozitive të investimit, deri në datën, 31.12.2026 ndërkohë që menjëherë mbas kalimit të këtij afati, Fondacioni do të kryejë dorëzimin përfundimtar të këtij investimi për Bashkinë Shkodër.
e. Të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve të mësuesve të shkollave dhe komunitetit për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe reagimit ndaj ndryshimeve klimaterike.
f. Të promovojë këtë investim, si mundësi dhe model i ri zhvillimi në punën me institucionet shtetërore dhe donatorët e tjerë.
g. Të bashkëpunojë me Bashkinë për identifikimin e mundësive dhe burimeve të financimit për kryerjen e investimeve të ngjashme në territorin e saj.
h. Të sigurojë dhe të ndajë me Bashkinë, një kopje të raporteve dhe të ofrojë informacion periodik mbi ecurinë e zbatimit të projektit dhe të dhënat e gjeneruara prej tij.
i. Të bashkëpunojë me Bashkinë për hartimin e një plani të përbashkët veprimi për të siguruar vazhdimësinë e Projektit edhe pas përfundimit të kësaj Marrëveshje.
j. Cdo demtim i objektit gjate kryerjes se investimit eshte ne pergjegjesi te investitorit/sipermaresit , te cilet duhet te pergjgjen per demin e shkaktuar duke e riparuar

dhe kthyer ne gjendjen fillestare

*3.2 **Bashkia merr përsipër**:*

a. Të angazhohet që të lehtësojë procedurat administrative që lidhen me marrjen e lejeve për të kryer investimin.
b. Të ngarkojë Strukturën/ Strukturat përkatëse.
    -të marrë në dorëzim dhe kalojë në inventar të saj këtë investim, pas dorëzimit të tij nga OSFA.
    -të mirëmbajë në vazhdimësi investimin e kryer nëpërmjet këtij projekti në të shtatë shkollat në kuadër të kësaj Marrëveshje.
c. Të ngarkojë Strukturën/Strukturat përkatëse

    -të ndjekë zbatimin e projektit, koordinimin dhe mbarëvajtjen e tij përgjatë gjithë kohëzgjatjes së marrëveshjes.
    -të mbajë marrëdhënie të vazhdueshme me komunitetin e zonës, ku do të kryhet investimi dhe të lehtësojë procesin e komunikimit dhe konsultimit të ekipit të projektit me banorët dhe aktorët e tjerë për t'u përfshirë.
    -të sigurojë pjesëmarrjen aktive në Komitetin e Administrimit që do të organizohet për menaxhimin efikas të investimit.
    -të promovojë këtë investim si mundësi dhe model të ri zhvillimi brenda shërbimeve të ofruara nga Bashkia, por edhe më gjerë.
c. Të kontribuojë në identifikimin e mundësive dhe burimeve të financimit për kryerjen e investimeve të ngjashme në territorin e Bashkisë dhe të iniciojë grupe pune përkatëse.
d. Të koordinojë procesin me të shtatë shkollat për të rregulluar kushtet dhe mënyrën e përdorimit të fondit/ose kryerjes së investimit në shkollat e përfshira bazuar në kursimin nga fatura e energjisë , parandalimin e shpërdorimit të energjisë dhe mbajtjes së komunikimit me komunitetin shkollor në funksion të zbatimit të projektit.
e. Kursimi vjetor ne faturen e energjise perdoret per nevojat e shkolles (riparim, mirembajtje, investim, etj) ne perputhje me kerkesat e drejtuesve të shkollave, të cilat kthehen në formën e investimit për përmirësimin e mjedisit shkollor.
f. Të përdorë energjinë e prodhuar nga impiantet sipas mënyrës së parashikuar në këtë Marrëveshje edhe pas datës 31.12.2026 (periudhë në të cilën impiantet do t'i kalojnë në dorëzim përfundimtar ,Bashkisë nga Fondacioni).

***Detyrime të përbashkëta të palëve:***

a. Bashkia Shkodër, në bashkëpunim me Fondacionin, do të komunikojë me OSHEE me qëllim arritjen e një marrëveshje të "matjes neto" të energjisë, e cila bën të mundur që çdo njësi (këh) energji elekrike që do të injektohet në rrjetin publik të OSHEE do ti njihet Bashkisë Shkodër dhe do ti zbritet nga konsumi i saj në pika të ndryshme.
b. Nëse nuk do të arrihet marrëveshja e mësipërme, mbiprodhimi i energjisë krijuar për shkak të energjisë që nuk do të konsumohet nga shkolla, do të transferohet falas në rrjet në favor të OSHEE.
c. Për menaxhimin efikas të investimit Fondacioni me Bashkinë do të krijojnë Komitetin e Administrimit, i cili përbëhet nga përfaqësuesi i Bashkisë, përfaqësuesi i Fondacionit, një

përfaqësues nga stafi menaxherial i secilës shkollë dhe një përfaqësues i komunitetit të prindërve për secilën shkollë. Komiteti i Administrimit drejtohet nga përfaqësuesi i Bashkisë. Komiteti i Administrimit mblidhet të paktën 2 herë në vit dhe diskuton mbi mbarëvajtjen e projektit dhe i paraqet një raport periodik Bashkisë dhe Fondacionit për ecurinë e projektit. Raporti mund të paraqesë rekomandime për përmirësimin e zbatimit te projektit. Komiteti i Administrimit ka për detyrë trajtimin e ankesave të mundshme që mund të paraqiten nga komuniteti i shkollës. Komiteti ushtron detyën e vet deri në përfundim të Marrëveshjes.

d. Fondacioni dhe Bashkia përjashtohen nga çdo përgjëgjësi për humbjet dhe dëmet financiare që mund ti shkaktohen palëve në rast se nuk përmbushet objekti i Marrëveshjes. Gjithashtu, në rast se ndodhin dëmtime të sendeve të luajtshme ose të paluajtshme, ose të subjekteve të treta gjatë ndërtimit të impianteve ose mbas përfundimit të projektit, Fondacioni dhe Bashkia do të përjashtohen nga çdo përgjëgjësi dhe përgjegjës për dëmin e shkaktuar do të jetë subjekti privat i cili do të realizojë ndërtimin e impianteve (detyrime të cilat do të saktësohen në kontratën e lidhur midis subjektit privat dhe Fondacionit).

**Neni 4**
**Kohëzgjatja dhe Hyrja në Fuqi**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe do të jetë e vlefshme deri në datën 31.12.2026 (periudhë në të cilën impiantet do t'i kalojnë në dorëzim përfundimtar ,Bashkisë nga Fondacioni).

**Neni 5**
**Zbatimi dhe Zgjidhja e marrëveshjeve**

5.1 Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për të qenë partnerë në zbatimin e projektit dhe të punojnë së bashku për realizimin me sukses të aktiviteteve të tyre.

5.2 Palët angazhohen që t'i zgjidhin mosmarrëveshjet vetëm e ekskluzivisht me mirëkuptim në mbështetje të interesit më të lartë publik e shoqëror.

5.3 Në rast se zgjidhja e mosmarrëveshjes me mirëkuptim nuk do të rezultojë e mundur, atëherë palët drejtohen për zgjidhje pranë gjykatës kompetente .

**Neni 6**
**Personat e kontaktit**

6.1 Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje, qofshin me gojë apo me shkrim, si elektronike ashtu edhe të shtypura në letër, i drejtohen personalisht personave të kontaktit përcaktuar nga secila nga palët, si më poshtë vijon:

a) Për Bashkinë Shkodër
Adresa: Rruga "13 Dhjetori", Nd. 9, H 1, 4001 Shkodër, Shqiperi.
E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al
b) Për Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë - OSFA
Adresa: Rr. "Qemal Stafa", Pallati 120/2, Tiranë, Shqipëri.

E-mail: dritan.nelaj@osfëb.org Tel.: +355 4 2234621/ 4 2234223/ 4 2235856/ +355 686075559

6.2 Këta persona do të jenë përgjegjës për saktësinë e protokolleve, proces-verbaleve, listave dhe çdo dokumenti shoqërues që ka të bëjë me përgatitjen dhe miratimin e Projektit.

6.3 Në rast të ndryshimit të njërit nga këta persona, pala e cila përfaqësohet prej këtij personi duhet të njoftojë me shkrim palën tjetër nënshkruese brenda një jave kalendarike për të dhënat e personit të ri të kontaktit.

**Neni 7**
**Dispozita të fundit**

**7.1** Palët përgjigjen reciprokisht për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, për realizimin e bashkëpunimit në funksion të arritjes së qëllimit të kësaj marrëveshjeje.

7.2 Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, Drejtoria e Komunikimit dhe Promovimit te Territorit,Drejtoria e Mjedisit dhe Energjisë së Rinovueshme,Drejtoria e Planifikimit të Investimeve dhe Mirëmbajtejs së Objkteve.

7.3 Çdo rregullim ose ndryshim në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, mund të kryhet vetëm me shkrim dhe nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.

7.4 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përgatitur në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje, 2 (dy) për Bashkinë Shkodër dhe 2 (dy) për Fondacionin.

| | |
|---|---|
| **Për Bashkinë Shkodër** | **Për Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë** |
| **Benet Beci** | **Andi Dobrushi** |
| Kryetar | Drejtor Ekzekutiv |
| ______________ | ______________ |

# REPUBLIKA E SHQIPERISE

## ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISE SE PALUAJTSHME

# CERTIFIKATE 822941

## PER VERTETIM PRONESIE

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 8593

Numri i Pasurise 2/682 Volumi 42 Faqe 82

Adresa e Pasurise SHKODER

Lloji i Pasurise TRUALL

Siperfaqja Totale 4169.25 m² (KATERMIJE E NJEQIND E GJASHTEDHJETE E NENTE PIKE NJEZET E PESE)

Nga kjo Sa Truall 4169.25 m² Nga kjo Sa NderTesa 1370

Nqs pallat Kuota e pjesemarrjes — %

## KJO CERTIFIKATE LESHOHET PER TE VERTETUAR QE

Zoti ( Zoterinjte )

| Emri | Atesia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA SHKODER | | | 1 | SHKODER |

eshte pronar i PASURISE ME NR 2/682

jane bashkepronare sipas pjeseve me lart —

eshte perfaqesues i familjes e cila ka ne pronesi —

kufizimet e pasurise jane: V2/123, 109, 662, L2/233, 174, 6/1, J2/182, 545, 257, P2/304, 302, 668, 170, 125

Kjo çertifikate plotesohet ne perputhje me Ligjin e Regjistrimit te Pasurive te Paluajtshme.

Kjo çertifikate leshohet sipas kerkeses se paraqitur nga i (te) interesuari (t) me date 21.11.2013 Nr. 9641

Data e leshimit te çertifikates

06.06.2014

Leshuesi i çertifikates
REGJISTRUESI

( OREST ZULI )

REPUBLIKA E SHQIPERISE
REGJISTRIMI I PASURIVE
Z.V.R.P.P.
SHKODER

**HARTE TREGUESE REGJISTRIMI**
**FRAGMENT**

| ZYRA VENDORE E RREGJISTRIMIT<br>TE PASURIVE TE PALUAJTSHME<br>SHKODER<br><br>Punoi<br>Inxh. Bardhi SHLLAKU | **A. IDENTIFIKIMI I PASURISE**<br>Z.K. 8593 Nr.PASURISE 2/ 682 V. Fq.<br>INDEKSI I HARTES SH - K - 9 SHKALLA 1 : 500<br>ADRESA E PASURISE: Rrethi Shkoder , Q. Shkoder<br>rr. Kardinal Mikel Koliqi, nr.42, 46.<br><br>KUFIZIMET C. PRONARI<br>V 2/ 123, 109, 662<br>L 2/ 233, 174, 6/1 Bashkia Shkoder<br>J 2/ 172, 545, 257, 668, 170<br>P 2/ 307, 302, 126, 125<br><br>Siperfaqe totale 4169.25 m2 truall, nga te cilat 1370 m2 ndertesa (shkolle), 3, 2, dhe 1 kate.<br><br>Date 18.11.2013 Zona 2 , Kerkesa 6628 ora. 09.09 |
|---|---|



# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia SHKODER

Fusha e perdorimit te Prones: ARSIMI

Identifikoi: Nedret Qehaja Specialiste topografe
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Kujtim Domnori Specialist inxhinier
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Artan Haxhi Kryetar Bashkie Tel 02243720
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| Nr. Rend. | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 48 | 8593 I-10 | 13/3 | Nd.Truall | Shkolla e ulet e Ndertimit | 1574 | 842 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 49 | 8593 K-9 | 2/171 2/234 | Nd.Truall | Shkolla "I.Misja" | 4634 | 1378 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 50 | 8592 J-7 | 3/296 | Nd.Truall | Shkolla" O.Kuka " | 2808 | 477 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 51 | 8591 N-7 | 4/234 4/25 | Nd.Truall | Shkolla "28 nentori" | 3425 | 1173 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 52 | 8593 L-10 | 6/317 6/318 | Nd.Truall | Shkolla " Pyjore " | 5097 | 917 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |

NR.
DERGUAR NGA:
LENDA:
TITULLARIT:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Këshilli i Ministrave**

# V E N D I M

**Nr.** 421 **, datë** 2.6.2010

## PËR

## MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

## V E N D O S I:

1. Miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

   Lista e inventarit me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

LULZIM BASHA

Bashkia Shkodër

Lidhje 1 ( E pjesshme )

| **Numri rendor i pronës në listën e inventarit** | **Fusha e përdorimit të pronës** | **Lloji i transferimit** |
|---|---|---|
| 7,13-19,21-23 | Prona që përdoren në fushën administrative. | Në pronësi |
| 32-73,851,852,853, | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 78-86,90-95,854 | Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik( shërbim parësor). | Në pronësi |
| 216,218-225 ( pjesa e paprivatizuar e 225),228-234, | Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore. | Në pronësi |
| 241-248, | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social. | Në pronësi |
| 107-109,121-135,173-205, | Zhvillim ekonomik | Në pronësi |
| 330-403, | Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 621-631 | Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik. | Në pronësi |
| 619-620, | Infrastrukture vendore | Në pronësi |
| 578,579, | Shërbim funeral | Në pronësi |

**MINISTRI**

**LULZIM BASHA**

Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSMINISTRI

[illegible]

4

NR.PROT.2103/1
DATË 9.6. 2010

MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
BASHKISË SË SHKODRËS
KËSHILLIT TË QARKUT TË SHKODRËS
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA

Sekretar i Përgjithshëm

PLANIMETRIA KATIT PERDHE



PLANIMETRIA KATIT PARE



ADNAN BUSHATI



ADNAN BUSHATI

SHKODRA OSA KUKU

# REPUBLIKA E SHQIPERISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISE SE PALUAJTSHME

## ÇERTIFIKATË 027845

PER VERTETIM PRONESIE

Zyra e Regjistrimit: SHKODER — Zona Kadastrale Nr. 8592

Numri i Pasurise: 3/296 — Volumi: 12 — Faqe: 130

Adresa e Pasurise: SHKODER

Lloji i Pasurise: TRUALL

Siperfaqja Totale: 2808 m² (DYMIJE E TETEQIND E TETE)

Nga kjo : Sa Truall: 2808 m² — Nga kjo : Sa Nderlesa: 477 m²

Nqs pallat : Kuota e pjesemarrjes ____ % (KATERQIND E SHTATEDHJETE E SHTATE)

### KJO ÇERTIFIKATE LESHOHET PER TE VERTETUAR QE

Zoti ( Zoterinte )

| Emri | Atesia | Mbiemri | Pjesa | Adresa |
|---|---|---|---|---|
| BASHKIA | | SHKODER | | |

eshte pronar i: PASURISE ME NR. 3/296

jane bashkepronare sipas pjeseve me lart: ____

eshte perfaqesues i familjes e cila ka ne pronesi: ____

kufizimet e pasurise jane: V 3/96, 99, 3/102, 101 L 3/291, 20 J 3/415 P 3/103, 34

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) me datë 17.12.2010 240

Data e lëshimit të çertifikatës: 20. 12. 2010

Lëshuesi i çertifikatës REGJISTRUESI

( HERZAN KALAJTSH )

ZYRA E REGJISTRIMIT SHKODER

Shkolla "Oso Kuka"

# HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

ZYRA E REGJISTRIMIT
TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
SHKODER

G. Z.V.R.P.P. SHKODER

## A. IDENTIFIKIMI I PASURISE

ZONA KADASTRALE 8532 NR.PASURISE 3/296 VOL. 12 FQ. 130
INDEKSI I HARTES SH-J-7 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISE: Rrethi SHKODER Q/F SHKODER
Rr/L______ P/G______ Sh______ K______ Ap______

**B. KUFIZIMET**
V. 3/96,99,102,101
L. 3/291,70
J. 3/414
P. 3/103,437

PRONARI
Bashkia Shkoder

$S_{Tr} = 2808 m^2$, $S_{nd} = 477 m^2$
(3 kat)

Dt.___/___/2010 Ora____



# Shkolla - OSO KUKA

## kati Perdhe



# Shkolla - OSO KUKA
## kati Pare



# Shkolla - OSO KUKA

## kati Dyte



Republika e Shqiperise

Komuna Rrethina

Shkoder

**VENDIM**

**Nr 6 date 02/02/2011**

Keshilli i Komunes Rrethina ne mbledhjen e dates 02.02.2011, mbështetur në nenin 3, të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", në nenin 8 të ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", i ndyshuar, në Vendimin nr.500, datë 14.08.2001, të Këshillit të Ministrave "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore" si dhe në përputhje me udhëzimin nr.3, datë 18.07.2002 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme të shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore", të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit.

**VENDOSI:**

1. **Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Rrethina.**

**a).Lista e Inventarit fillon nga numri 1 (një) dhe mbaron me numrin 721 (shtatëqind e njëzet e një) dhe përbëhet nga 109 (njëqind e nëntë) fletë.**

2. **Paraqitjen e listës së inventarit për miratimin në Këshillin e Ministrave.**

**Per Keshillin e Komunes Rrethina**

**Sekretari**

**Tonin Dedaj**

**Kryetari**

**Gjelosh Prendi**

# ...FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia / Komuna : Rrethina

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim

Identifikoi: Sabri GURI Dhurata DEKOVI
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Myzafer GURI (Topograf)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Gëzim HARDOLLI (Kryetar Komune)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| Nr. Rend. | A: Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | A: Nr. Pasurise | A: Lloji i Prones | B: Emri i Prones Adresa | B: Sip. Totale e Prones (m2) | B: Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | C: Funksioni per te cilin perdoret Prona | C: Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | C: Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | C: Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 1965<br>187 - B | 49/1 | Truall +<br>Ndërtesë | Shkolla 9 - vjeçare<br>Hot I Ri<br>Komuna Rrethina | 1800 | 160 | Arsim<br>parauniversitar | M.A.SH | D.A<br>Shkodër | V.1 [illegible] |
| 2 | 1790<br>K-34-64<br>177 - B | 61/7 | Truall +<br>Ndërtesë | Shkolla 9 - vjeçare "Haxhi Hajdari"<br>Fshati Golem<br>Komuna Rrethina | 6175 | 768 | Arsim<br>parauniversitar | M.A.SH | D.A<br>Shkodër | Brenda ka kopësht për fëmijë.<br>V.1 [illegible] |
| 3 | 1869<br>162 - C | 126/23 | Truall +<br>Ndërtesë | Shkolla 9 - vjeçare "Tringe Smajli"<br>Fshati Grudë e Re<br>Komuna Rrethina | 4212 | 750 | Arsim<br>parauniversitar | M.A.SH | D.A<br>Shkodër | V.2 [illegible] |
| 4 | 1869<br>162 - C | 375/18<br>126/24 | Truall | Shkolla 9 - vjeçare<br>Fshati Grudë e Re<br>Komuna Rrethina | 2514 | | | M.A.SH | D.A<br>Shkodër | Jashtë funksionit |
| 5 | 1105<br>1103<br>K-34-64<br>178 - D | 336 | Truall +<br>Ndërtesë | Shkolla 9 - vjeçare<br>Fshati Bardhaj<br>Komuna Rrethina | 1182 | 130 | Arsim<br>parauniversitar | M.A.SH | D.A<br>Shkodër | V.2.7.56 |

1

# SHKOLLA 9 VJEÇARE GRUD E RE(TRING SMAJLI ) 2K

SIP.= 562.0 m2

PLANIMETRIA KATI PERDHE SHK. 1:100



SHKOLLA 9 VJEÇARE GRUD E RE(TRING SMAJLI ) 2K

SIP.= 446.0 m2

PLANIMETRIA KATI PARE SHK. 1:100



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KOMUNA VELIPOJE
KESHILLI I KOMUNES

**VENDIM**

**Nr. 33 Date 11.12.2013**

**"Për miratimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne Komunen Velipoje"**

Këshilli i Komunēs Velipoje në mbledhjen e tij të datēs 11.12.2013, mori në shqyrtim projekt-vendimin e kryetarit te komunes Velipoje Për miratimin e inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne Komunes Velipoje.

Bazuar ne ligjin 8652, datë 31.07.2000 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndyshuar neni 3, ne ligjin nr. 8743, adte 22.02.2001 "Per pronat e paluajtshme te shtetit" i ndryshuar neni 8, ne VKM nr. 500, date 14.08.2001 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore" si dhe ne perputhje me Udhezimin e Ministrise se Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr. 3, date 18.07.2002 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme te shtetit nga njesite e qeverisjes vendore", pas diskutimeve te keshilltareve me 10 vota pro, 1 kunder dhe 2 abstenim:

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listes se inventarit te pronave te paluajtshme shteterore ne Komunes Velipoje, Qarku Shkoder.
    a. Lista e inventarit fillon me numrin 1 (nje) dhe mbaron me numrin 279 (dyqind e shtatedhjet e nente), dhe ka 48 (dyzet e tete) flete.
2. Paraqitjen e listes se inventarit per miratim ne Keshillin e Ministrave.
3. Ky vendim hyne ne fyqi pas konfirmimit nga Prefektura Shkoder.
4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Komunes.

KESHILLI I KOMUNES VELIPOJE
KRYETARI
Bledar ÇETINA

Shpallur me daten 20.12.2013

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Komuna : Velipoje

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim

Identifikoi: Ndue Pllumbi (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Gjovalin Bregnaj (Specialist)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Pashko UJKA (Kryetar i Komunes)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 6 | 1799 | | Truall dhe ndertese | Shkolle Gomsiqe e Re Komuna Velipoje | 490 | 490 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe Sportit | Drejtoria Arsimore Shkoder | |
| 7 | 3734 | | - | Shkolle Velipoje e Re | 3230 | 219 | - | - | - | |
| 8 | 1076 | | - | Shkolle Baks Rrjolle Komuna Velipoje | 1036 | 162 | - | - | - | |
| 9 | 3160 | | - | Shkolle Rec Pulaj Komuna Velipoje | 354 | 106 | - | - | - | |
| 10 | 2500 | | - | Shkolle Luarze Komuna Velipoje | 626 | 91 | - | - | - | |

SHKOLLA NIKOLL ZAGORJANI VELIPOJE

2 KATE SIP.=505.0 m2

PLANIMETRIA KATI PERDHE SHK. 1:100



SHKOLLA NIKOLL ZAGORJANI VELIPOJE

PLANIMETRIA KATI PARE SHK. 1:100

2 KATE SIP.=478.0 m2



# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

## (Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia SHKODER

Fusha e perdorimit te Prones: ARSIMI

Identifikoi: Nedret Qehaja Specialiste topografe
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Kujtim Domnori Specialist inxhinier
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Artan Haxhi Kryetar Bashkie Tel 02243720
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

REPUBLIKA E SHQIPERISE ... SHKODER

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 32 | 8594 P-7 | 8/118 | Nd.Truall | Shkolla "A.Laçej" | 1927 | 1042 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 33 | 8594 O-8 | 6/497 | Nd.Truall | Shkolla" Deshmoret e Prishtines" | 5062 | 625 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 34 | 8593 N-9 | 9/494 | Nd.Truall | Shkolla"N.Mazi" | 3375 | 865 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 35 | 8591 N-6 | 1/229 | Nd.Truall | Shkolla "N.Mjeda" | 3500 | 608 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimore | |
| 36 | 8591 L-6 | 6/6 | Nd.Truall | Shkolla "S.Halili" | 5586 | 1007 | Arsimi Parauniversitar | Ministria e Arsimit | Drejtoria Arsimit | |

NR. 1892 DATE
DERGUAR NGA:
LENDA:
KABINETI I TITULLARIT:

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Këshilli i Ministrave**

# V E N D I M

**Nr.** 421 **, datë** 2.6.2010

**PËR**

## MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

   Lista e inventarit me 196 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 855 (tetëqind e pesëdhjetë e pesë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**KRYEMINISTRI**

**SALI BERISHA**

MINISTRI I BRENDSHËM

LULZIM BASHA

Bashkia Shkodër

Lidhje 1 ( E pjesshme )

| Numri rendor i pronës në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 7,13-19,21-23 | Prona që përdoren në fushën administrative. | Në pronësi |
| 32-73,851,852,853, | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 78-86,90-95,854 | Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik( shërbim parësor). | Në pronësi |
| 216,218-225 ( pjesa e paprivatizuar e 225),228-234, | Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore. | Në pronësi |
| 241-248, | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social. | Në pronësi |
| 107-109,121-135,173-205, | Zhvillim ekonomik | Në pronësi |
| 330-403, | Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile. | Në pronësi |
| 621-631 | Prona që përdoren në fushën e ndriçimit publik. | Në pronësi |
| 619-620, | Infrastrukture vendore | Në pronësi |
| 578,579, | Shërbim funeral | Në pronësi |

**MINISTRI**

**LULZIM BASHA**

Në mungesë dhe me porosi
ZËVENDËSMINISTRI

E. [illegible] PONI

4

NR.PROT.2103/1
DATË 9.6. 2010

MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
MINISTRISË SË PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE DHE SHANSEVE TË BARABARTA
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
BASHKISË SË SHKODRËS
KËSHILLIT TË QARKUT TË SHKODRËS
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA

Sekretar i Përgjithshëm

KËSHILLI I MINISTRAVE

# Shkolla - DESHMORET E PRISHTINES

## kati Perdhe



# Shkolla - DESHMORET E PRISHTINES

## kati Pare



# Shkolla - DESHMORET E PRISHTINES

## kati Dyte



# PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : BASHKIA SHKODER | DATE : 30 / 05/ 2024 | QELLIMI : RREGJISTRIM

VENDNDODHJA

BASHKIA : SHKODER | DVASHK/ZVASHK : SHKODER | ZONA KADASTRALE : 8594 | NUMRI PASURISE : 6/69 | INDEX HARTE : SH : o-8

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI I PASURISE : TRUALL+NDERTESE | SIP.PASURISE = 3647 m2 | SIP. GJURMES NDERTIMIT = 625 m2 | NUMRI I KATEVE : | VL. | FQ.

X 459785.88
Y 4658478.79

## KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X 459830.82
Y 4658478.37




SH : 1 : 1000

| Nr. | ORIENTIMI | PERDORIMI | TIPI KUFIRIT | KUFITARI | ID/NIPT | SHENIME TE REALIZUESIT |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | VERI | | | 6/305 | | |
| 2 | LINDJE | | | 6/ 77,404,517 | | |
| | JUGU | | | 6/ 501,517, | | |
| 4 | PERENDIMI | | | 6/ 268,307,12, | | |

DREJTORIA ASETEVE DHE KADASTRES URBANE

DREJTORI: LULZIM MASHI

PUNOI. SPECIALISTI : ARJAN VASIJA

LICENCA NR : 7.01445 DATE : 31/01/2017

ZV/KRYETAR

NENSHKRIMI / VULA

REALIZOI PER ASHK

DVASHK

SPECIALISTI

NENSHKRIMI

KONFIRMOI

PERGJEGJESI / DREJTORI

NENSHKRIMI / VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; z-zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-matje Distancash;

PERCAKTIMI I KUFIRIT:
Kode per percaktimin e kufirit; P-Perfaqesues I Pronave ; K-Kufitaret te Gjithe ; KP-Kufitaret Pjeserisht ; PB-Perfaqesues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA : HARTUAR SIPAS ORJENTIMEVE TE SHKRESES NR.2111/1 DT. 24/05/2024 DERGUAR NGA DVASHK SHKODER.

(SHKOLLA DESHMORET E PRISHTINES)

PRONARI / BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MAREDHENIET ME KUFITARET

EMRI: BASHKIA SHKODER

NENSHKRIMI

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; z-zyre;o-Ortofoto;G-GPS; S-Stacion Total; d-matje D-Matje Distancash; p-Perfaqesues i Pronarve; k-kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht; PB- Perfaqesues Bashkie, HK- Harta Kadastrale

# PLAN RILEVIM

| PERGATITI | IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| Drejtoria Juridike<br>Sektori I Aseteve | ZONA KADASTRALE 8594 |
| Ing. Manjola LESHA | NR. PASURISE 6/69 |
| Adnan BUSHATI | INDEKSI I HARTES SH - 0-8 |
| | SHKALLA 1:500 |
| | ADRESA E PASURISE: RRETHI SHKODER |
| | QYTETI: SHKODER |
| | PRONARI<br>BASHKIA SHKODER |
| Data e përgatitjes 15. 07. 2013 | $S_{truall}$ = 5962 $m^2$<br>$S_{ndertimi}$ = 625.0 $m^2$ |

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA SHKODER SEKRETARIA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# V E N D I M

Nr. 1086 , datë 23.7.2008

PËR

## MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GUR I ZI, TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Gur i Zi, të qarkut të Shkodrës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 67 (gjashtëdhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 383 (treqind e tetëdhjetë e tre).

17/12/2015

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Gur i Zi për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

BUJAR NISHANI

Komuna Gur i Zi

Lidhje 1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1-9 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. | Në pronësi |
| 10-11 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik. | Në pronësi |
| 12-14 | Prona që përdoren në fushën kulturore dhe sportive. | Në pronësi |
| 15-25 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 26-35 | Infrastrukture ( troje të lira) | Në përdorim |
| 192-221;256-265 | Infrastrukture (rruge vendore) dhe shërbim publik. | Në pronësi |
| 232-254 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit. | Në përdorim |
| 255;270;276;284;288;293; 300;309;311;315;319;321; 324 | Toka bujqësore inproduktive,kanale të treta. | Në pronësi |

MINISTRI

Bujar NISHANI

NR.PROT.3229/1
DATË 1.8.2008

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLIT TË QARKUT TË SHKODRËS
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretar i Përgjithshëm

REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I MINISTRAVE

# 1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Komuna : Guri i Zi

Fusha e perdorimit te Prones: Arsim

Identifikoi: Veneranda Pjetri (Specialiste)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: Domenika Pjetri (Specialiste)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: Broz Marku (Kryetar Komune)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

| | A | | | B | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend. | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1 | 2302 | 335 | Truall ndertese | Shkolla 8 vjeçare Fshati Kuç Komuna Guri i Zi | 1300 | 181 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe e Shkences | Drejtoria Arsimore Shkoder | |
| 2 | 2802 | 204 | Truall ndertese | Shkolla fillore Fshati Kuç Komuna Guri i Zi | 128 | 86 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe e Shkences | Drejtoria Arsimore Shkoder | |
| 3 | 3168 | | Truall ndertese | Shkolla 8 vjeçare Fshati Rrenc Komuna Guri i Zi | 2000 | 433 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe e Shkences | Drejtoria Arsimore Shkoder | |
| 4 | 1898 | | Truall ndertese | Shkolla 8 vjeçare Fshati Vukatane Komuna Guri i Zi | 1653 | 213 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe e Shkences | Drejtoria Arsimore Shkoder | |
| 5 | 2008 | | Truall ndertese | Shkolla 8 vjeçare Fshati Juban Komuna Guri i Zi | 4760 | 469 | Arsim parauniversitar | Ministria e Arsimit dhe e Shkences | Drejtoria Arsimore Shkoder | |

PLANIMETRIA KATIT PERDHE SHK. 1:100

SHKOLLA RRENC

SIP.=540.0 m2



PLANIMETRIA KATIT PARE SHK. 1:100

SHKOLLA RRENC

SIP.=375.0 m2

